




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në seancën e **II (e dytë)** të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, më datë 6.3.2013 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 1. Informatë për efektshmërinë e inkasimit të kushtëzuar nga administrata e komunës për **KRUK "Hidromorava"**
 2. Informatë për efektshmërinë e inkasimit të kushtëzuar nga administrata e komunës për kompaninë **"Eco-Higjiena"** Shpk,
 3. Rregullorja për fuqizimin e vullnetarizmit në komunë,
 4. Propozim Projekti për themelimin e Muzeut të Komunës,
 5. Propozim vendimi për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike për një pjesë të PDU: Zona Perëndimore Qarku",
 6. Propozim vendimi për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për student të dalluar.
 7. Propozim vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për student të dalluar,
 8. Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për Përcaktimin e Listës së lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve dhe Simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjiçanit,
 9. Propozim vendimi për emërimin e Këshillit Komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjiçanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë,
 10. Propozim vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashfrytëzuara nga viti fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013,
3. **Të ndryshme,**

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së dytë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit,

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa,

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu,

Përfaqësuesi i OSB-së, z. Basri Sejdiu

Përfaqësuesi i OJQ “Anamorava”, z. Isa Shefkiu

Drejtorja e Kompanisë “Hidromorava”, znj. Mirvete Hoti

Drejtori i Kompanisë “Eco-Higjiena”, z. Bajram Isufi

Mediet

Seancën e dytë të KK-së e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, përfaqësuesit e OSB-së dhe të gjithë drejtorët duke i përfshirë edhe drejtorët e Kompanisë “Hidromorava” dhe “Eco-Higjiena”.

Në vijim kryesuesi kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Pas verifikimit që e bëri sekretari, u konstatua se në këtë seancë janë të pranishëm 40 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi një 1: Enver Hajrullahu

Procesverbali nuk pati vërejtje i cili u aprovua pa vërejtje

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

Izmi Zeka – ne në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi pajtuar që të punojmë me këtë rend të punës, por nëse ka dikush diçka për të shtuar mund të urdhërojë.

Arben Maliqi- unë së pari i përshëndes të gjithë anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe drejtorët e dy kompanive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në punimet e kësaj seance. Në vijim të fjalës z. Maliqi theksoi se ka qenë një punë e mirë më parë kur jemi marrë vesh të gjithë shefat e grupeve parlamentare paraprakisht, por ai kolegjiun më nuk po funksion, prandaj unë në këtë seancë do t’ i ngrit tri çështje ose shqetësime të qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Së pari si shqetësim i qytetarëve është tatimi në pronë e cila problematikë nuk na takon neve, por së paku dikush duhet të na jep informatë për qytetarët e Gjilanit.

Mandej një dukuri brengosëse është te varrezat e qytetit, sepse unë aty jam habitur vetë kur kam parë varre të hapura (kjo është shumë rëndë për qytetarët).

Shqetësimi i tretë është lidhur me faturat e fryra nga KEKU, e cila kompani është mirë që të na japin një informatë pse po ndodh kjo dukuri?

Gjithashtu duhet ta kemi edhe një informatë nga Administrata e Përgjithshme lidhur me ndryshimin në qasje të dokumenteve, sepse qytetarët këto ditë po ballafaqohen me probleme të shumta, por një gjë e di që fajtorë nuk është Komuna, por faji është në qendër. Në fund shfrytëzoj rastin që të gjithëve t’ ia uroj festat e marsit të gjithëve si 7 Marsin, 8 Marsin etj.

Izmi Zeka- rendi i punës është aprovuar në KPF, kurse kolegji i shefave do të funksionojë që nga seanca e ardhshme. Një çështje që e përmendi Arbeni është ajo se ju e dini se 5, 6 dhe 7 Marsi janë një ndër ditët më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, sepse këto janë ditë që ka ndodhur rënia e familjes së jasharëve në Prekaz.

Ne ka qenë desh që tas mbajmë një seancë të posaçme në përkujtim të veprës heroike të jasharajve, sepse kjo datë dhe kjo ngjarje është një ndër më sublimet jo vetëm në Kosovë, por në mbarë trojet shqiptare. Epopeja e jasharajve e ka ndryshuar historinë e popullit shqiptarë dhe në sajë të asaj sakrifice, ne sot po gëzojmë këtë liri.

Sami Azemi- unë i përshëndes të gjithë të pranishmit, por edhe unë po theksoj se 5, 6 dhe 7 Marsi janë ditë të mëdha historike. Është manifestimi kryesor i cili mbahet nën patronatin e kryeministrit të Kosovës, prandaj dita e sotme është për të bërë homazhe duke filluar nga varri i Komandantit legjendar Adem Jashari dhe duke vazhduar në të gjitha varrezat dhe komplekset memoriale në Kosovë.

Kjo është arsyeja që unë e them se kjo ditë fare nuk është e qëlluar që po mbajmë seancë të rregullt, por ka qenë desh të jetë një seancë festive dhe nuk ka qenë desh të jetë i vetmi KK në Kosovë që po mban seancë të rregullt. Unë propozoj që kjo seancë të shtyhet për ndonjë ditë tjetër në shenjë respekti për të gjithë të rënit për liri të Kosovës.

Sabedin Kadriu- neve para fillimit të seancës na u shpërndan disa kalendar, por ai që i shpërndau t' i marrin menjëherë, sepse unë nuk e pranoj, sepse këtu është bërë një diskriminim fetar, sepse xhamisë i duket vetëm minarja, prandaj edhe kishës ka qenë desh t' i duket vetëm kryqi. Xhamisë i duket vetëm minarja, kurse kisha është komplet, unë nuk jam fetar, por kjo është diskriminim për mua.

Sokol Haziri- u thanë shumë gjëra, por unë do të them diçka për rendin e ditës.

Nuk kam ndonjë pikë të veçantë, por kam për të thënë diçka për informatën e Hidromoravës dhe Eco-Higjienës. Ne dhe më herët kemi debatuar lidhur me këto dy vendime kontroverse që i ka sjell ky Kuvend dhe sot kërkoj që sot të dy kompanitë të deklarohen lidhur me arsyen, kontributin dhe rritjen e inkasimit lidhur me kushtëzimin e qytetarëve për shlyerje të borxheve për këto kompani. Ne nuk mundemi vazhdimisht që me forma të tilla të rregullojmë performacën e tjetër kujt. Për këtë arsyeje kërkoj që pas informacionit të këtyre kompanive të bëhet edhe një deklaram i kuvendarëve lidhur me këtë çështje.

Izmi Zeka- ne në çdo mënyrë do ta anulojmë këtë vendim, sepse edhe Ministria e Pushtetit Lokal e ka tërheq vërejtjen dhe ne pas informatës do ta bëjmë edhe një elaborim në seancën e ardhme dhe përfundimisht kushtëzimi në këto ndërmarrje do të hiqet. Gjithashtu në seancën e ardhme do t' i kemi të gjitha vendimet e KK-së për të cilat MPL ka kërkuar për t' u rishqyrtuar dhe asnjë vendim i cili bie ndesh me ligjet në Kosovë nuk mund të jetë në fuqi.

Arben Mehmeti- atë që e tha kryesuesi sa i përket vendimeve të paligjshme ka qenë kërkesë e LDK-së qysh herët që të anulohet çdo vendim i cili është në kundërshtim me ligjin e Republikës së Kosovës. Mirëpo është mirë që morët këtë qëndrim që në seancën e radhës të debatohen këto vendime të kundërligjshme, por edhe të sanksionohen ata të cilët i kanë

zbatuar këto vendime. Duhet të kihet parasysh se ka sanksione atëherë kur marrim dhe zbatojmë vendime të paligjshme.

Gjithashtu edhe sa i përket kalendarit të cilët u shpërndan për të pranishmit në sallë, këtu është një diskriminim fetar dhe grupi i LDK-së nuk i pranon këta kalendar, sepse janë kalendar diskriminues në aspektin fetar. Kjo të jetë si vërejtje për ata që kanë lejuar që të dalin në publik një kalendar i tillë dhe të tallen qytetarët me këtë.

Është hera e pestë e grupit parlamentar të LDK-së që po kërkojmë informatë për veprimet që i keni marrë lidhur me transmetimin e seancave të KK të Gjilanit. Të dihet se është hera e pestë që grupi parlamentar i LDK-së kërkon që KK të jetë në shërbim të qytetarë të Komunës së Gjilanit dhe me vendimet që i bie ky Kuvend dhe të ndikon që ata të jenë pjesë e qeverisjes dhe pjesë e vendimmarrjes në Komunën e Gjilanit.

Besoj se kryesuesi do të na njoftojë për veprimet e ndërmarra edhe pse premtimet kanë qenë se do të realizohet kjo kërkesë.

Sa i përket pikave të rendit të ditës, ne si grup parlamentar kërkojmë që të bëhet një lëvizje dhe disa pika të rendit të ditës të hiqen me qëllim që të mos ngarkohet kjo seancë.

Ky reduktim duhet të bëhet edhe për atë se u tha se është një datë e rëndësishme dhe nuk ia vlen që të merremi me shumë pika të rendit të ditës. Ne propozojmë që të mbahet një seancë brenda një dy jave maksimumi për t' u debatuar pikat e tjera të rendit të punës.

Ne konkretisht po kërkojmë që pika tre të shtyhet për seancën e radhës, mandej pika 4, 8 dhe pika 9.

Mirëpo si pikë e veçantë kërkojmë që nga Drejtoria e Administratës të na epet një njoftim i shkurtër lidhur me maltretimin i cili është duke iu bërë qytetarëve të Komunës së Gjilanit (çështja e sistemit të ri të dokumentacionit). Në këtë Kuvend duhet të njoftohen qytetarët se ku është problemi. Mandej në Administratë është krijuar një problem me sigurimin, sepse po të zbresim në Administratë është sikur të jemi në ndonjë objekt në pjesën veriore të Mitrovicës. Është një siguri tepër i madh dhe është një sjellje e sigurimit sikur të jenë sovran i qytetarëve. Sigurimi është pjesë teknike dhe nuk e kanë të drejtën e ndërhyrjes te terminet dhe nuk guxojnë të diskriminojnë qytetarë të cilët presin në radhë.

Kërkoj që drejtori i Administratës të na njoftoj posaçërisht për këtë pikë, pastaj do të themi edhe ne diçka.

Ne këto nuk i kemi debatuar në komitet, por kjo është çështje e ngutshme, sepse në parim pajtohem me atë që duhet të debatohet për ato gjëra që i kemi rekomanduar në komitet.

Është edhe një problem e cila vlen për Drejtorin e Shërbimeve Publike, sepse është çështja e një rruge në “Dardani” e cila kalon afër Postës në drejtim të Shkollës “Selami Hallaçi” e cila rruga është me një kahe, por në rrugë parkohen vetura dhe qytetarët duhet të kalojnë në mes të rrugës. Kërkoj që kjo drejtori ta merr një veprim të caktuar dhe mos të lejojë asnjë parkim të automjeteve për të pasur mundësi që qytetarët të lëvizin lirshëm. Këto janë shqetësime të grupit parlamentar të LDK-së.

Izmi Zeka- shqetësimet janë të përgjithshme dhe nuk janë të asnjë lagjeje, sepse Komuna ka obligime për tërë qytetin dhe jo vetëm të një lagjeje. Disa shqetësime ndoshta ngriten, sepse Radio Energji është duke e bërë incizimin e drejtpërdrejtë, kurse TV “VALI” do ta bëjë më vonë.

Edhe unë pajtohem me atë se kjo seancë ka koiciduar me Epopenë e jasharajve dhe jam për atë që seanca të ndahet në dy pjesë, por duhet bërë një prerje deri në pikën pesë për të cilat do të debatohet sot, kurse të tjerat të mbesin në seancën e radhës.

Mirëpo duhet bërë një lëvizje dhe pika 10 për shkak të urgjencës, duhet të kalojë në 4, kurse pika 4 mbetet për seancën e radhës.
Kush është për këtë rend të punës?

Aprovohet rendi i punës me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

1. Informatë për efektshmërinë e inkasimit të kushtëzuar nga administrata e komunës për KRUK “Hidromorava

Izmi Zeka- për këtë kompani është kërkuar një informatë nga këshilltarët e cila informatë është dhënë në KPF, por edhe në këtë seancë drejtorja e Hidromoravës është e pranishme e cila do ta jep këtë informatë para kuvendarëve.

Mirvete Hoti- unë iu falënderoj të gjithë kuvendarët dhe kryetarin e Komunës për mbështetjen që na e ka dhënë neve si kompani dhe pse sot deklaratat e kuvendarëve na dekurajuan me ato propozimet e tyre për heqje të kushtëzimit të qytetarëve ndaj kësaj kompanie. Sa i përket kushtëzimit të qytetarëve për shlyerje të borxheve ndaj kësaj kompanie për shfrytëzim të ujit, ky vendim i ka sjell shumë dobi kësaj kompanie dhe inkasimi është rritur për 90 mijë euro ose shpreh në përqindje ka rritje të konsiderueshme, por ajo çka është me rëndësi është bërë një vetëdijesim i qytetarëve.

Mirëpo gjatë fjalës së saj drejtorja dha edhe të dhëna të tjera për këtë kompani, por të cilën informatë e ka dorëzuar edhe shkrim të cilën informatë anëtarët e Kuvendit e kanë në materialin e seancës.

Izmi Zeka- e falënderojmë drejtoreshën për këtë informatë, por ajo theksoi se ka edhe në Kuvend persona ose kuvendarë të cilët nuk kanë shlyer obligimet ndaj kësaj kompanie, por ajo ka qenë desh sot ta sjell atë listë dhe jo vetëm të anëtarëve të Kuvendit, por të të gjithë qytetarëve. Duhet të dihet se kush është i përgjegjshëm ndaj institucionit dhe nuk i kryen obligimet qytetare për pa marrë parasysh se kush është ai. Duhet të bëhen publik të gjithë ata njerëz, sepse disa thirren në parime, kurse vetë nuk i zbatojnë parimet. Drejtorja të gjithë këta emra duhet t’i publikojë edhe në shtyp dhe çdo mjet tjetër informativ.

Sokol Haziri- unë dua të them se në këtë mënyrë nuk mund të komunikojë drejtoresha dhe nuk do të brengoset askush se dikush do të na publikon në shtyp emrat, sepse ne i kemi punët tona i kemi obligimet tona dhe qytetare dhe politike. Do të ishte më mirë dhe më korrekte të flasim për problemet tona të cilat i cekëm. Nuk është çështja aspak e këtij Kuvendi se çka ka përgjegjësi drejtorja e Hidromoravës. Ajo është kompani e cila është e themeluar prej Qeverisë dhe Asambleja Komunale nuk ka të bëjë asgjë me këtë kompani, absolutisht asgjë. Ne dëgjuam një ligjëratë politike dhe juridike për të drejtat dhe kushtetutshmërinë për të cilat janë organet të cilat i shtrojnë këto probleme.

Herën tjetër nuk do të lejojmë kësë farë qasje ndaj kësaj trupe politike e që është trupa më e lartë e qytetarëve të Gjilanit.

Izmi Zeka- një gjë duhet ditur? Duhet harruar se nuk është obligim që të kryhen obligimet komunale kushdo qoftë ai. Duhet që t’i kryejë obligimet secili pa marrë parasysh a është themeluese Qeveria apo Komuna.!

Unë kërkoj prej drejtores që të na e sjell listën e atyre që nuk i kanë kryer obligimet ndaj Hidromravës. Nuk ka nevojë të flasim shumë vetëm të na sillet lista për të parë se cilët nga anëtarët e Kuvendit nuk i ka kryer obligimet?

Sokol Haziri- e para dhe po e përsëris, ne nuk e kemi këtë të drejtë as nuk e kemi pasur të merremi me këtë çështje në këtë formë dhe në këtë mënyrë. Unë në fillim të seancës dhe në vazhdimësi kam kërkuar që ky vendim dhe të tjerët, por nëse e krahasojmë Eco-Higjienën, ndoshta kemi pasur mundësi të bëjmë diçka, sepse ne jemi themelues. Mirëpo te ujësjellësi nuk kemi asnjë kompetencë dhe fundi i fundit nuk është e obliguar as për të na informuar. Unë nuk e di sa ka kushtuar objekti i administratës ku është akomoduar bukur dhe mirë administrata e Hidromoravës dhe nëse ai është ai shërbim i mirë për qytetarët për mua nuk është fare! Është shërbim i mirë kur të mos sillet ujë jo kualitativ që sillet përmes gypave të vjetër, prandaj të rregullohet kjo, atëherë të akomodohet edhe administrata. Mirëpo jo me prioritet njëherë të bëhet objekti, e kur të arrijmë ta rregullojnë çështjen e ujit.

Sa i përket listave edhe unë jam ai që e kam një borxh të pakryer e cila faturë më ka ardhur pas 13 muajve dhe ai që kam borxh jam unë. Nëse mendoni se frikohem dhe fshihem pas saj është gabim, sepse 13 muaj asnjë inkasant nuk ka qenë në shtëpinë time.

Ju e dini listën e fundit kur e kemi marrë ka qenë me zero tek unë dhe prej asaj date nëse ka mundësi të krijoj mbi 1 mijë euro shpenzim, atëherë unë nuk komentoj këtë dhe kjo është punë organeve të tjera që do të merren me këtë dhe jo Kuvendi. Për këtë arsyeje unë kërkoj që të merremi me gjëra që jemi kompetent dhe mos të merremi me gjëra që nuk na takojnë!

Qemajl Mustafa- unë iu përshëndes dhe po filloj prej kësaj të fundit që e tha Sokoli i cili tha se nuk kemi pasur të drejtë të merremi me këtë çështje? Juridikisht bazuar në ligj ne jemi të kufizuar, sepse me Ligjin e ri me të cilin Komuna në të cilat i jep shërbim një ndërmarrje rajonale siç është Hidromorava përcaktojnë gjysmën e bordit të asaj komune. Me ligjin e ri mbi ndërmarrjet publike ne edhe juridikisht tash kemi ingerencë, tash kemi kompetencë mbi këtë kompani dhe kompania me këtë ligj është e obliguar për të dhënë informacion ose raport edhe në KK.

Nuk qëndron kjo që nuk kemi pasur të drejtë deri më tash, sepse gjatë gjithë fushatave zgjedhore, por jo vetëm gjatë fushatave zgjedhore, opozita vrapon dhe e ka në program premtimin për qytetarët e Komunës se do t' i furnizojnë kualitativisht dhe mjaftueshëm me ujë. Nëse është kjo kështu, atëherë ne kemi obligim edhe moral edhe faktik po edhe mos ta kishim obligim ligjor, kemi obligim de fakto ndaj qytetarëve. Kemi këtë obligim, sepse dalim dhe i premtojmë se do t' i furnizojmë me ujë dhe qëllimi i asaj kompanie është për t' i shërbyer qytetarëve të Komunës.

Vendimi të cilin e kemi ndërmarrë sot e kësaj dite e kam bindjen e plotë është një vendim plotësisht i ligjshëm. Është vendim që nuk e cenon të drejtën e njeriut, por e avancohet të drejtën e qytetarit të kësaj Komune dhe komunave të tjera. Këtë po e them se vetëm duke i inkasuar mjetet për artikullin e konsumuar kërkohet një pjesë të borxhit të akumuluar për artikullin e përdorur. Përdorimi i mirë i atij inkasimi bënë dhënien e shërbimit të mirë të qytetarëve dhe te rasti i Hidromoravës dhe Eco-Higjienës.

Është një fakt se një ministri me një sekretar i cili është tepër i mençëm i gjithëdijshtëm shkruan anekdota dhe bënë presion sidomos te komunat të cilat qeverisën nga PDK që të hiqet ky kushtëzim. Mirëpo kurrë hiq nuk e thekson asnjë të vetmin ligj dhe as të një vetmin nen me të cilin janë dëmtuar të drejtat ligjore të qytetarit. Kemi të bëjmë me një njeri të politizuar, dihet mirë prejardhja e tij, dihet kush është, dihet prej kur është aty e cili e bënë

një presion jo parimor. Sa mua më përket kjo mbetet në fuqi derisa kompanitë thonë mirë jemi financiarisht. Por nëse konstatojmë që ky kushtëzim nuk ka kontribuar shumë kompanisë dhe në anën tjetër nëse ne konstatojmë si Kuvend se ky kushtëzim ka sjell mjete të bollshme dhe kompanitë i ka sjell në gjendje të mirë, gjithashtu është mirë të hiqet. Do të duhej me ngritje të vetëdijes duhet çdo qytetarë t' i kryejnë obligimet ndaj këtyre kompanive. E lus drejtoreshën që mos të hezitojnë që të gjithë ata që vjelin të mira prej buxhetit, por nuk i kanë kryer obligimet patjetër t' i publikoni! Ne jemi të obliguar për t' i dhënë emrat e 2600 të punësuarve sa i kemi, kurse ju konstatojnë se kush nuk i ka kryer obligimet edhe ju edhe drejtori i Eco- Higjienës.

Izmi Zeka- në seancën e ardhshme e debatojmë këtë çështje, a ka pasur efikasitet apo jo? A ka qenë ligjore apo jo? Sot është informata dhe mos u fokusoni në gjëra të tjera.

Elisah Ymeri- sot është Epopeja e UÇK-së dhe sot 15 vjet më parë Adem Jashari dhe trimat tjerë ishin në luftë për liri, sot 15 vjet më parë u ndryshoi historia e Kosovës, kurse ne sot po mbajmë seancë dhe mirë që po e mbajmë falë gjakut të tyre, por unë kërkoj një orë pushim për të shkuar te Varrezat e Dëshmorëve për t' i nderuar ata Dëshmorë me një minutë heshtje. Unë e kërkoj këtë përkrahje prej juve, sepse këtë vit e kemi pasur edhe 5 Vjetorin e Pavarësisë për të cilën datë nuk është mbajtur as mbledhje solemne, por edhe sot është desh që të ftohemi dhe të bëjmë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Unë kërkoj prej juve një orë pushim, për të shkuar te Varrezat e Dëshmorëve, të përkulemi para tyre dhe pastaj të kthehemi dhe ta bëjmë punën tonë.

Izmi Zeka- unë për dallim nga Elisahu, po propozoj që njëherë t' i debatojmë 5 pikat e rendit të ditës të cilat i aprovuam, pastaj mund të shkojmë te Varrezat e Dëshmorëve.

Ejup Haziri- unë pajtohem me Elisahun që në ora 11 t' i nderojmë ata dëshmorë dhe tash në ora 11 të bëjmë homazhe dhe mandej të kthehemi dhe vazhdojmë me punë!

Sadudin Berisha- ne nuk jemi dhe nuk kemi qenë asnjëherë që t' i japim vlerësimet individuale për askënd, posaçërisht ata që nuk kanë kompetencë dhe aftësi profesionale për ta bërë këtë. E dyta po thuhet politikë, por nga kryetari i Komunës kjo është më shumë se politikë, sepse prek individit në ministri dhe Qeveri e cila udhëhiqet nga partia në të cilën është edhe kryetari. Nëse një zyrtar qeverie shkel ligjet, kryeministri me mandatin e tij ka të drejtë ligjore për ta shkarkuar atë zyrtarë mbi bazën ligjeve sistemore.

Sa i përket informatës ne pozicionin tonë e kemi dhënë me kohë se LDK për ato Udhëzime që nuk janë paraparë me ligj nuk mund të mbështesë asnjë vendim të tillë.

Informacioni që është dhënë nuk shihet se janë dhënë rezultate të çmuara në funksion të inkasimit dhe obligimit të argumentit. Shihet një lëvizje e vogël e institucionit e të cilët ka qenë desh të jenë më të disiplinuar për t' i kryer obligimet mujore, qoftë prej Eco- Higjienës si Kompani e PPP-së, qoftë të Hidromoravës.

Së dytë LDK, asnjëherë nuk i ka bërë ftesë qytetarët për të mos i kryer obligimet qytetare, por përkundrazi vazhdimisht ka apeluar te qytetarët që të vetëdijesohen dhe t' i kryejnë obligimet. Ne jemi të vetëdijshëm se nëse nuk kryhen obligimet për këto dy çështje shërbimet nuk mund të jenë kualitative. Mirëpo nuk mund të shfrytëzohet KK si institucion jo kompetent që të merr vendime të kundërligjshme. Zotëri kryetari thotë është plotësisht me ligj dhe e

kundërshton një vlerësim të bazuar ligjor të Ministrisë së Pushtetit Lokal e që do të thotë është i interesuar të nxjerr vendime jo të ligjshme!

Tatimi në pronë dhe kushtëzimi për tatimin në pronë është në mënyrë taksative e precizuar dhe nëse obliguesi i tatimit në pronë nuk i kryen obligimet ka norma për ta obliguar për ta kryer atë tatim. Për këtë arsyeje ne kemi kërkuar edhe më herët që të shfuqizohet në mënyrë automatike, sepse në momentin kur ministria përgjegjëse nxjerr vendime se kur një vendim i tillë, por edhe shumë vendimeve të tjera ato mbeten jashtë zbatimit. Nëse jo sot në seancën e radhës kërkoj që këto vendime për dy kompanitë të shfuqizohen. Hidromorava duhet qytetarët që t' i detyrojë që përmes mekanizmave tjerë ligjor për t' i kryer obligimet. Është një numër të madh të qytetarëve të cilët i kryejnë obligimet në mënyrë të rregullt dhe ka shfrytëzues ilegal, por dhe të instaluar me leje, por të cilët asnjëherë nuk kanë bërë pagesë. Cilat janë veprimet të cilat i ka marrë Hidromorava për t' i detyruar ato familje apo ato ndërmarrje për ta bërë pagesën? Asnjë informacion nuk e kemi sot. Sa qytetarë janë paditur në gjykatën kompetente et? Për këtë arsyeje ky Kuvend nuk mund të shërbejë servis i njëres apo tjetres kompani.

Izmi Zeka- mos u thirrni shumë edhe në Kuvend, sepse duhet ditur se politikën në Gjilan e bëjnë ata që e kanë pushtetin. Opozita e ka një mundësi për të dhënë kontribut sa të mundet dhe nëse ka kapacitete, kurse të gjitha politikat edhe zhvillimore dhe politike i bënë pozita dhe nuk ka nevojë shumë për ligjërata.

Arben Mehmeti-sa i përket tatimit në pronë e tha edhe parafolësi se kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe ky inkasim duhet të bëhet pa tjetër dhe aty nuk kemi dilema dhe asnjëherë nuk e kemi kundërshtuar. Mirëpo ka ankesa se Qeveria e Republikës së Kosovës 100% e ka rritur tatimin në pronë për objektet e banimit do të thotë përkundër asaj që ka pasur premtime se jeta e qytetarëve do të jetë më e lirë dhe me shërbime më të mira. Me një ekonomi të pazhvilluar me një krizë të madhe financiare në Kosovë 100% të rritet tatimi në pronë ka ndodhur vetëm në Kosovë.

Mirëpo kjo është përgjegjësi e dikujt dhe qytetarët do ta vlerësojnë në të ardhmen se kush do ta ketë atë përgjegjësi.

Po ashtu nga kryetari i Komunës u tha se të gjitha këto kushtëzime janë ligjore, por ne si grup parlamentar i LDK-së i kemi dërguar shkresa zyrtare në institucionet përkatëse duke filluar nga MPL dhe Komisionit Ndërministror i cili është marrë me këto fusha.

Ata e kanë konstatuar se këto vendime janë në kundërshtim me ligjet dhe posaçërisht të Hidromorava është në kundërshtim me ligjin, sepse deri më tash kjo kompani nuk është menaxhuar nga Komuna. Se çka do të ndodh tash me ligj nuk e kemi të qartë, por deri më tash nuk është përgjegjësi e Komunës. Në momentin që Komuna merret me një kompani që nuk përgjegjësi ligjore ndaj saj, është një kundërshtim ligjor, pavarësisht asaj që mund ta ndihmojë kompaninë në aspekte të ndryshme, por nuk e ka obligim ligjor. Po ashtu edhe drejtorja e cila këtu paraqitet se ka këshilltarë komunal, është mirë që mos të spekulojë asgjë në këtë drejtim. Së pari ajo ka qenë desh të vijë këtu me një raport detal të atyre që janë borxhli, sepse ajo ka pasur informatë se sot kemi seancë. Në këtë formë të spekulojë se ka këshilltarë, ka drejtorë, etj, nuk është mirë.

Para Kuvendit duhet të flitet me argumente dhe duhet ofruar ato argumente? Ne nuk guxojmë që mos t' i kryejmë obligimet ligjore, sepse jemi organi më i lartë i Kuvendit.

Po ashtu nuk e kemi edhe një raport nga këto dy kompani se punëtorët e këtyre dy kompanive, p.sh punëtorët e Kompanisë Hidromorava a janë borxhli të Kompanisë Eco-Higjiena. Edhe në këtë rast ka qenë desh të bëhet një analizë më e mirë dhe anasjelltas. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e thotë se qytetarët duhet të kushtëzohen dhe në momentin që nuk e thotë që duhet të kushtëzohen dhe për këtë arsyeje i bie që ky vendim i kushtëzimit është në kundërshtim me kushtetutën. Kjo lëndë është në Gjykatën Kushtetuese dhe pritet vendimi në favor të qytetarëve, sepse është konstatuar se është kundër kushtetues dhe shumë shpejtë do të bëhet publike.

Unë nuk e kam të qartë pse kryesuesi ato shkresa i mban mbyllur në sirtarët e vetë dhe i mban mbyllur, sepse ne e kemi informatën se këto shkresa kanë ardhur më herët. Këtu duhet të jep llogari kryesuesi, sepse është pjesë e kësaj Qeverie dhe duhet t' i zbatojë vendimet!

Arben Maliqi- ne e përshëndesim raportin e drejtores dhe këtë e kemi debatuar dhe në KPF dhe duhet ta dimë që kur flasim për qytetarët mos ta përdorim këtë termë politikisht, por t' i themi disa gjëra shumë të rëndësishme. Unë mendoj që sëpari duhet bërë një analizë a ka pasur sukses, apo nuk ka pasur sukses kushtëzimi? Edhe në shtetet më demokratike ata të cilët bëjnë gabim edhe aty dënohen qytetarët e tillë. Ne dimë se vetëm tatimi në pronë është me ligj, mirëpo a janë të mira apo nuk janë të mira kushtëzimet duhet ta analizojmë?

Unë mendoj se kushtëzimet vlejné për qytetarët e pandërgjegjshëm, sepse duhet ta dijnë secili se uji, rryma duhet paguar. Unë mendoj se kushtëzimet duhet t' i analizojmë mirë, duhet të mendojmë mirë dhe të mos marrim vendime ad-hok, por ta shikojmë ta analizojmë dhe duhet ta dimë mirë që uji i është i domosdoshëm. Ka qytetarë të cilët ujin e përdorin për larjen e automjeteve, ujin e keqpërdorin dhe ata të mos e paguajnë ujin dhe ne të mos marrim asnjë mekanizëm mbrojtës kjo nuk ka logjikë. Duhet ta analizojmë mirë, duhet të mendojmë mirë se çka po bëjmë? Vendimet duhet t' i marrim preraz dhe duhet të mendojmë për të mirën e qytetarëve.

Ibish Ibishi – unë i përshëndes të gjithë dhe po theksoj se ne në këtë Kuvend jemi për të debatuar për çështjet të cilat na preokupojnë neve dhe të gjithë qytetarët. Kur është fjala te informata të cilën e paraqiti drejtorja e cila e përmendi efektin e kushtëzimit dhe kërkoi që ky kushtëzim të vazhdojë edhe më tej. Mirëpo në informatë janë të dhënat vetëm për shërbimet të cilat epen në qytet (Gjilan), kurse në anën tjetër nuk e thotë asnjë fjalë për ujësjellësit të cilët gjenden nëpër fshatra, sepse edhe në fshatra duhet dhënë shërbime.

Unë saktësisht e kam fjalën për ujësjellësin e fshatit prej nga jam unë (Mireshe) i cili ujësjellës ende është i papërfunduar, sepse kompania e cila e ka marrë për obligim për t' i kryer punët nuk i ka kryer ashtu si duhet dhe nuk i ka përfunduar punimet.

Unë e përfaqësoj atë pjesë dhe unë këto probleme në këtë Kuvend i paraqes në emër të atyre qytetarëve dhe për këtë kemi pasur takime edhe me punëtorët e Kompanisë të cilët janë zotuar se do t' i kryejnë këto obligime, por që prej asaj kohe nuk është ndërmarrë asgjë.

Në anën tjetër kemi vërejtje, sepse faturohen edhe ata qytetarë të cilët nuk kanë instalim të ujësjellësit ! Drejtoresha e ka pasur për obligim për të dal në terren për të parë dhe vërtetuar se kush ka lidhje legale dhe kush ilegale dhe në bazë të këtyre fakteve ta bëjë faturimin. Kjo për mendimin tim është jo ligjore, ashtu si thotë drejtoresha mospagesa e faturave. Unë kërktoj që të dilet në terren, të identifikohen këto probleme të rregullohet çështja e ujësjellësit, të furnizohen qytetarët, pastaj të fillojë faturimin.

Qemajl Mustafa- ne kemi thënë se do ta miratojmë një raport në Bord, në të dy bordet dhe diku në muajin prill të na sillët një informacion i detajuar i punës vjetore. Do të thotë një informacion për çështjen në fjalë, se sa ka krijuar efekt ky kushtëzim te këto dy kompani. Atëherë kur të debatohet për atë raport kemi të drejtë edhe disa orë për të debatuar rreth asaj se si po funksionon kompania.

Zijadin Maliqi- ne e kemi marrë informatën në të cilën bëhet fjalë vetëm për kushtëzimet për të cilën informatë kam shumë vërejtje. Në këtë informatë neve na parashtrohen pyetje dhe nuk ka desh të bëhen këso pyetje neve si anëtarë të Kuvendi, sepse këto janë pyetje provokative dhe të gjithë e dimë që uji a është falas apo duhet të paguhet?

Ne këto gjëra i kemi thënë gjithmonë, por edhe në Komitetin për Shërbime Publike kur kemi biseduar dhe kemi kërkuar që qytetarët t' i kryejnë obligimet. Unë jam njëri prej atyre që me përjashtim të ujësjellësi i kam 30-40 euro, kurse obligime të tjera nuk kam absolutisht ndaj asnjë kompanie. Jam obligues i tyre dhe për kushtëzim asnjëherë nuk bëj pagesën, sepse nuk posedoj asnjë automjet, por e kam obligim qytetarë, sepse e di që e shpenzoj ujin dhe i shfrytëzoj edhe të mirat e kompanive të tjera. Këto pyetje më duket se janë jo të nivelit për t'ia parashtruar këshilltarëve komunal.

Sa i përket efekteve të Hidromorava , unë e kam analizuar informatën dhe e kam parë se ka efekt diku për 5% për periudhën 1.5 vjet, në krahasim me periudhën e njëjtë të kohës së pakushtëzuar. Në bazë të faturimit që është bërë kemi rritje diku prej 5% . Ne e kemi thënë se këtu e kemi një efekt pozitiv, por në anën tjetër të tatimi në pronë kemi pasur efekt negativ. Ne në bazë të raporteve periodike e kemi parë se duke e bërë krahasimin me periudhat e kaluara kemi pasur rënie. E përmendi kryetari jo punëtorët, jo menaxheri, por unë mendoj se nuk është faji i tyre, por është faji se njerëzit i ikin këtij kushtëzimi dhe shkojnë i regjistrojnë automjetet nëpër komunat e tjera.

Xhelal Shabani- (drejtor i financave në Hidromoravë)- drejtori i financave e dha një raport të Kompanisë para dhe pas kushtëzimit, por të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë marrë me shkrim në materialin e seancës.

Abdyl Aliu- unë kërkoj prej të gjithë qytetarëve të Gjilanit që t' i paguajnë të gjitha taksat dhe të gjitha detyrimet që i kanë. Mirëpo duke e lexuar këtë raport në të cilin thuhet po të ndalej uji vetëm për 24 orë a thua çfarë do të ishin pasojat dhe çfarë do të ishin çrregullimet? Çrregullimet i dimë se çfarë do të ishin, për pasoja nëse do të ishte një mungesë e tillë drejtorja me tërë stafin e tij menjëherë do të duhej të shkojnë në shtëpi dhe në vend të tyre do të duhej të vijë dikush tjetër i cili do të mund t' i del zot asaj pune dhe obligimi që është ndaj qytetarëve. Gjithashtu duhet theksuar se menaxhmenti i Kompanisë duhet ta gjejnë mënyrën se si t' i inkasojnë mjetet për shpenzim të ujit, sepse kjo është problem i tyre.

Në këtë mënyrë para luftës kanë qenë disa organizata të cilat kanë mbledh borxhe dhe njëra prej tyre ka qenë “sedma silla” që kanë mbledh borxhe, të cilat kanë qenë ilegale dhe me një përqindje i kanë marrë borxhet firmave të ndryshme. Mua më vjen keq që Komuna ka ra në këtë gjendje dhe nuk mund t' i nxjerr borxhet.

Izmi Zeka- ne jemi më të prirur që të flasim vetëm për anët negative, kurse ato pozitivet nuk i shohim. Edhe unë e kam një qëndrim për kushtëzimet, por duhet ta dimë se aktualisht furnizimi me ujë është më i mirë se çdo herë.

2. Informatë për efektshmërinë e inkasimit të kushtëzuar nga administrata e komunës për kompaninë **“Eco-Higjiena”** Shpk,

Bajram Isufi- drejtori i Eco- Higjienës e dha një informatë lidhur me punën e kësaj kompanie, por këtë informatë anëtarët e Kuvendit e kanë në material të seancës.

Sokol Haziri- e falënderoj drejtorin për këtë informatë të cilën e dha para kuvendarëve dhe unë kam vlerësim pozitiv për këtë punë e cila po bëhet dhe për efektshmëri të rritjes së faturave me radhë dhe çmimeve të arsyeshme. Ne jemi themelues të këtij institucioni dhe duhet t’i japim ndihmë në forma dhe metoda të cilat janë në pajtim me ligjin.

Sidoqoftë po mbetet që për këtë të bisedojmë më hollësisht në seancën e radhës, por vetë mënyra e komunikimit, por tregon se janë dy qasje ndaj Asamblesë Komunale, prandaj duhet ditur se si duhet të veprojnë kompanitë të cilat janë nën juridiksionin e Komunës e cila duhet edhe t’i jap llogari Komunës. Sidoqoftë unë e përgëzoj punën e mirë të kësaj kompanie, por të mirën ta kthejmë me të mirë dhe me ligj dhe me atë që e kemi përgjegjësi.

Qemajl Mustafa- në seancën e ardhshme do të na vijë raporti financiar dhe në atë seancë do të diskutojmë më gjatë për të gjitha aspektet, por dua vetëm t’i përgjigjem Zijadini se auditimi i brendshëm ka treguar se qytetarët nuk po shkojnë për t’i regjistruar automjetet në komuna të tjera. Këtë po e them se për 9 muaj përsëri janë regjistruar rreth 8 mijë automjete dhe vetëm 200 janë më pak.. Nëse këtë numër e shumëzojmë me 100 € bëjnë 20 mijë euro. Absolutisht kjo nuk ka ndikuar në inkasim të mjeteve, por është neglizhenca e atij sektori (drejtori dhe menaxheri) i atij sektori janë dy përgjegjës. Këtë po e them se 23% deri te fundi i muajit të tetë kemi rënie drastike 23% secilin muaj të inkasimit të tatimit në pronë. Mirëpo kur ka filluar USAID-i për ta bërë një analizë dhe kur e kemi dërguar auditimin e brendshëm, menjëherë gjendja është përmirësuar edhe atë në plus për 84 mijë euro për tre muajt e ardhshëm. Me këtë është treguar se në muajin e nëntë të dhjetin dhe njëmbëdhjetin janë 84 mijë euro më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Nga kjo shihet se ka qenë një neglizhencë totale e një sektori dhe neglizhencën totale të një drejtori sa i përket kësaj çështje! Mirëpo së shpejti do ta kemi raportin financiar dhe do ta analizojmë ngadalë dhe do të shohim se si qëndron gjendja dhe duhet të dalim nga seanca me qartësi.

Arben Malqi- e falënderojmë drejtorin për këtë informatë precize dhe koncize dhe duhet ta dinë të gjithë se menaxhmenti i kësaj drejtorie duhet të jetë një model për të gjithë ata të cilët udhëheqin kompani. Është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe dhe për këtë po e përmendi vetëm një shembull dhe kjo shihet se me vendosjen e kontiniervë në lagjen tonë pastërtia është në nivel shumë më të mirë. Edhe vetëdija e qytetarëve, po ndryshon dhe shihet më se askush më mbeturina nuk hedh në rrugë. Do të thotë kjo ka mundur që mbeturinat të hidhen në vendin e duhur, por është edhe një fakt se shëndeti i fëmijëve tanë është në nivelin e duhur, sepse fëmijët më nuk kanë kontakt me mbeturina.

Kështu që unë do të dëshiroj të them se kjo Kompani është duke e bërë një punë mjaft të mirë, prandaj i uroj suksese dhe çdo të mirë.

Ibish Ibishi- unë i përshëndes të gjithë dhe posaçërisht drejtorin ekzekutiv të Kompanisë i cili e bënë një punë të mrekullueshme. Unë nuk po flas rreth raportit, por po e them se këtë kompani e përcjellin shumë probleme, por unë kërkoj nga drejtori që të na jep një sqarim

lidhur me kontratat punëtorëve, sepse sipas disa informatave thuhet se kontratat janë lidhur për tre muaj?

Izmi Zeka- kur të sillet raporti në Kuvend, atëherë këto gjëra duhet të precizohen dhe debatojmë më gjatë.

Sadudin Berisha- ne para dy vite e kemi marrë një vendim për PPP, në funksion të shërbimeve më të mira për t' i bërë qytetarëve dhe në këtë aspekt 49% të aseteve i posedon komuna, kurse 51% Kompania Austriake. Deri më sot kemi mangësi, por është formuar edhe një komision për mbikëqyrjen e mbarrëvajtjes së Marrëveshje së PPP-së, por me sa e di unë ai komision deri më tani asnjëherë nuk është takuar për të dhënë një vlerësim se sa mbrohen interesat e qytetarëve. Ne si LDK çdo inkasim që bëhet me vullnetin e qytetarëve është i mirëseardhur, mirëpo te pozicioni sa i përket çështjes së kushtëzimeve në këtë rast kur kemi të bëjmë edhe me PPP-në, qëndron ajo që kemi thënë dhe nuk është përgjegjësi e Komunës për të vënë kushtëzime për pagesën që i bën tash kompania tash për PPP-në. Ne nuk i themi qytetarëve mos e bëni pagesën dhe i thërrasim qytetarët që ta bëjnë këtë pagesë, por sërish e them që ky vendim në seancën e radhës së bashku me vendimin që ka të bëjë me Hidromoravën, duhet të shfuqizohet dhe të del vazhdimisht apeli ynë politik që çdo qytetarë t' i kryejë obligimet e tyre.

Bajram Isufi- u bë një pyetje lidhur me kontratat e punëtorëve, por duhet theksuar lidhur me këtë se vetëm dy menaxherë janë me kontratë 6 mujore e të cilët nuk janë pjesë kompanisë , kurse të gjithë punëtorët e tjerë janë me kontratë dyvjeçare.

Tefik Ibrahim- unë përshëndes, por fjala e z. Arben Maliqit më shtyri që t' i them disa fjalë, sepse ai e tha se në lagjen e tij çdo gjë qenka në rregull? Mirëpo unë po e theksoj se lagjja në rrugën “ Idriz Seferi” ose më herët është quajtur lagjja e Abaz Bukovikut, është e vjetër që nga viti 1958. Që nga i vit dhe deri më sot, qytetarët e asaj lagjeje e kanë të vetëm dhuratë ujësjellësin nga Komuna i cili është instaluar para 5-6 viteve. Mirëpo edhe uji herë vejnë herë, nuk vjen, ndriçim publik nuk ka, trotuar nuk ka, kurse Eco-Higjiena në tërë qytetin ka shpërndarë kontinjer, kurse kjo lagje nuk posedon me kontinjerë të tillë?

3. Rregullorja për fuqizimin e vullnetarizmit në Komunë,

Veton Nevzadi-- kjo rregullore për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit është rregullorja e parë që propozohet për miratim në Kosovë. Kjo rregullore në një mënyrë rregullon punën vullnetare të rinisë dhe punën vullnetare të qytetarëve në nivel të Komunës. Kjo rregullore në një mënyrë është edhe krenari kombëtare dhe me rëndësi është se kjo rregullore ka kaluar përmes një procesi të konsultimeve dhe debateve dhe në fund kemi ardh në procesin e aprovimit të kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore është e bazuar në Ligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve, neni 14 dhe është në pajtim me dispozitat e Udhëzimit administrativ për Komunë dhe të rinj.

Gjithashtu kjo rregullore normon aktivitet jo fitim prurëse dhe stimulon pjesëmarrjen e qytetarëve dhe forcon bashkëpunimin në mes qytetarëve dhe Komunës.

Unë iu lus që ta aprovoni në Kuvend dhe t'ia jepni mundësinë që të fillojnë edhe këto aktivitete vullnetare në Komunë.

Arben Mehmeti- unë edhe në KPF, kam kërkuar që Komuna e Gjilanit dhe drejtorja të rezervohet nga praktika për të nxjerr rregullore të cilat në praktikë janë problem për t' u zbatuar. Kjo rregullore ka kaluar në komitet, por nuk ka kaluar në Komisionin i cili është për akte normative, prandaj që kësaj rregulloreje t' i bëhet një rishikim (sepse ky komision dje e ka pasur një takim dhe jemi marrë vesh që të kalojë në Komision, pastaj të vijë në Kuvend. Këtë po e them, sepse është vendim i Kuvendit, që çdo rregullore duhet të kalojë përmes atij Komisioni dhe propozoj që të rikthehet formalisht në Komision për akte normative, pastaj të vijë në Kuvend.

Unë drejtorin e falënderoj për qëndrimin e tij gjatë manifestimit të "Flakës së Janarit" i cili në secilin rast na ka bërë ftesë me kohë e cila ka qenë një praktikë e re dhe e mirë në raport me një pjesë të drejtorëve të cilin fakt e kam thënë edhe KPF. Këtë shembull është mirë që ta praktikojnë edhe drejtorët e tjerë të drejtorive përkatëse.

Arben Maliqi- ne për këtë Rregullore kemi biseduar dhe në KPF dhe kemi thënë se kjo është për t' u përshëndetur, sepse ende në Republikën e Kosovës nuk e ka aprovuar askush këtë rregullore. Kjo është një rregullore për të mirën e fëmijëve tanë dhe për të mirën e prindërve tanë. Kjo rregullore ka të bëjë në edukimin e fëmijëve, në çelikosjen e fëmijëve dhe personi më i afërt i fëmijës është prindi dhe të gjithë ata të cilët e duan sportin e duan jetën dhe e duan perspektivën. Në këtë Rregullore shumë çka specifikohet, për të mirën e të rinjve tanë dhe pa hezitim ne jemi për ta mbështet.

Arzie Nuhiu- këtë Rregullore ne e kemi shqyrtuar edhe në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të gjithë njëzëri jemi pajtuar dhe kemi dhënë rekomandimin që të prezantohet në KPF dhe të aprovohet në Kuvend. Këtë e kemi propozuar duke marrë parasysh faktin që ne në Komunë kemi potencial të shumë rinor dhe kjo rregullore do të jetë në funksion të rinisë dhe në përgjithësi të Komunës së Gjilanit.

Arianit Sllamniku- unë sinqerisht e përshëndes punën e drejtorit Veton Nevzadi i cili për një kohë të shkurtër ka treguar një atraktivitet në menaxhimin e këtij sektori. Ky sektor është mjaft i ndjeshëm, sepse ka të bëjë me promovimin e vlerave të gjeneratës më të re në Komunën tonë. Mirëpo te kjo Rregullore unë kisha pasur dëshirë (nëse shkon në Komisionin për akte normative), të vlerësohet impakti i voluntarizmit të atij të riu në aktivitet përmes OJQ-ve të ndryshme. Impakti i cili ka të bëjë edhe me ndonjë pikë shtesë nëse merret kriter voluntarizmi i tij për ndarjen e bursave. Në këtë sektor dhe në këtë aspekt kishte qenë mirë edhe kjo të futet në ndonjë nen nëse del në Komisionin për akte normative. Mirëpo është një vërejtje ku Këshilli i veprimt lokal rinor (KVRL) të specifikohet qartë në nene si institucion ndoshta super OJQ në Komunë të Gjilanit. Edhe ajo është një OJQ në vete e cila ka një marrëveshje me OJQ-të e tjera. OJQ-të të cilat ceken në këtë rregullore do të duhej të jenë të barabarta në aspektin normativ ligjor të kësaj Rregulloreje.

Unë kërkoj që mundësisht t' i merrni për bazë këto dy këshilla për të mirën e të rinjve.

Sadudin Berisha- nuk po i përsëris ato që u thanë, por arsyeje pse ky akt nënligjor ka qenë desh të kalojë në Komision për akte normative është edhe në kuadër të detyrimit të vendimit të KK-së për formimin e komisionit për hartimin e akteve nënligjore në bashkëpunim me sponzoruesin e cila është DKRS. Sikur sot të miratohej kështu, nuk i epet mundësia këshilltarëve që të shikojnë përmbajtjen e neneve të cilat rregullojnë marrëdhëniet e brendshme

të kësaj fushe. Për këtë arsyeje kujtoj se Komisioni për akte nënligjore do të ishte në komunikim me sponzoruesin për ta bërë kompletimin e kësaj rregulloreje.

Ne nuk jemi kundër miratimit të këtij dokumenti, por që do të duhej të kalojë në këtë komision jo sa për anën formale, por të shikohet edhe ana përmbajtjesore.

Abdyl Aliu- e kam një vërejtje e cila nuk ka të bëjë me këtë pikë, por ka të bëjë me rendin e punës. Kemi bërë një shmangie dhe e kemi shkel rendin e punës të cilën shmangie e vërejta. Te pika e parë e rendit të punës nuk e kemi aprovuar procesverbalin i cili aprovim është me rëndësi. Unë nuk kam asnjë vërejtje, për mua procesverbali është në rregull, por është e udhës që të deklarohet Kuvendi.

Nuk pati ndonjë vërejtje lidhur me procesverbalin nga anëtarët e Kuvendit (konsiderohet si i aprovuar), plotësim i imi- S. Hasani.

Tahir Arifi- unë e falënderoj drejtorin e DKRS-së për punën që e ka bërë në këtë rregullore dhe unë e di që përmbajtjen e kësaj rregulloreje e ka bërë Zyra Ligjore dhe me sa unë e di ka kaluar nëpër komitetin tonë, sepse kam qenë në kontakt me drejtorin.

Përmbajtja e kësaj rregulloreje është e mbështetur fund e krye në ligje mbi të cilën është nxjerr kjo rregullore, kështu që do të dëshiroj që ta di nga Zyrtari ligjor se a duhet kjo rregullore të shkojë në atë Komision apo jo?

Hevzi Matoshi- u tha edhe nga parafolësit se nxjerrja e kësaj rregulloreje ka qenë një proces mjaft i gjatë dhe juridikisht janë plotësuar të gjitha kushtet paraprake për procedurën e cila ka qenë desh të ndiqet. Unë arsyet pse komisioni për akte normative nuk e ka shqyrtuar këtë rregullore i kam thënë edhe në KPF, mirëpo asgjë nuk e dëmton këtë rregullore nëse në parim aprovohet, por më vonë në Komision mund ta bëjmë edhe ndonjë rishikim.

Izmi Zeka- procedurat ligjore janë zbatuar, Zyra Ligjore i dha sqarime, prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për aprovim të pikës 3 të rendit të punës?

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Rregullorja për fuqizimin e vullnetarizmit në komunë, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjërin variant të votimit.

4. Propozim vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashfrytëzuara nga viti fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013,

Nuhi Nuhiu- siç po shihet edhe në vendim nga viti 2012 kemi mjete në vlerë prej 213.605.53 €, mirëpo ne kemi problem me pagat në Drejtori të Arsimit, prandaj pjesën dërmuese duhet t' i bartim për arsim 163 mijë e 916 duhet të kalojnë në arsim , kurse 50.485.71€, janë për investime kapitale. Këto mjete pastaj janë të përcaktuara në vendim se në cilin nivel të arsimit duhet të shkojnë, prandaj iu lus që ta aprovoni në Kuvend dhe mundësoni për ta bërë këtë bartje.

Sokol Haziri- unë së pari po e them arsyen pse nuk e votova pikën e më parme (rregulloren) është se ne e kemi formuar një komision i cili do të merrej me këto gjëra, kurse ai komision nuk është respektuar. E dyta ne mbështesim këtë propozim për bartje të mjeteve vetanke dhe uroj që të shfrytëzohen për këto qëllime.

Zijadin Maliqi- ne e dimë sa mjetet mund të barten prej, prej një viti në vitin tjetër si është rasti nga viti 2012, në vitin 2013, por nëse ka mundësi të na epet një sqarim si kanë mbetur mjetet e viti 2011 dhe tash barten në vitin 2013 dhe sa mjete barten të viti 2011?

Gjithashtu shihet se këto janë mjete vetanake dhe pjesa më madhe e tyre me përjashtim të Zyra e Kryetarit, një pjesë ndahen për investime kapitale, kurse të tjera për paga të punëtorëve, kur dihet se pagat bëhen nga niveli Qendror dhe aprovohen me buxhet.

Unë e di deri diku pse janë këto mjete, por është mirë të epet një sqarim pse janë disa mjete janë për numrin e punëtorëve e të cilët paguhen nga niveli Qendror?

Nuhi Nuhiu- nga viti 2011 barten mbi 3900€, kurse te paga në arsim jemi të detyruar të bëjmë pagesa, sepse kemi zëvendësime për çështje të ndryshme, kurse niveli Qendror nuk na lejon mjete për këtë qëllim. Për këtë arsyeje ne si Komunë duhet t' i bëjmë këto zëvendësime si për pushime të lehonisë dhe zëvendësime të tjera t' i mbulojmë me mjete vetanake.

Bahrie Veseli- pasi që kanë mbetur mjete të pa shpenzuara, nga vitet e kaluara ne në Komitetin e Arsimit, së bashku me drejtorin kemi biseduar që të gjendet mundësia që t' i kompensohen arsimtarëve shpenzimet e udhëtimit (ata të cilët udhëtojnë).

Kërkoj nga kryesuesi që këtë propozim timin ta hidhni në votim?

Izmi Zeka- ne e kemi në plan në seancën e ardhshme që ta diskutojmë çështjen e arsimtarëve të cilët udhëtojnë dhe mendojmë që ta gjejmë një zgjidhje për këtë çështje.

Këtë problematikë do të shikojmë me rishikim të buxhetit që ta zgjidhim.

Kush është për aprovim të pikës së 4 të rendit të punës?

Aprovohet pika 4 e rendit të punës: Propozim vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashfrytëzuara nga viti fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit

5. Propozim vendimi për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike për një pjesë të PDU: Zona Perëndimore Qarku”,

Bahrie Mamuti- ky propozim- vendim ka rrjedh si nevojë e zgjidhjes nga nevoja e disa banorëve të cilët kanë qenë të privuar nga qasja në pronën publike edhe pse kanë poseduar leje ndërtimi me planin e vitit 1984. Mirëpo Plani i cili është miratuar në vitin 2002 e ka cenuar të drejtën e këtyre qyfterëve të cilët kanë qenë të pajisur me leje dhe për këtë arsyeje ne e kemi bërë një ndërhyrje në planin e viti 2002 në vitin 2004. Ne si drejtori e kemi parë të arsyeshme që të bëhet një zgjidhje e cila do t' i harmonizon këto dy plane.

Duke pasur parasysh se qytetarët e kësaj zone kanë qenë të pajisur me leje ndërtimi dhe është parë e nevojshme që të bëhet një zgjidhje.

Në vazhdim të fjalës, drejtorja këtë propozim-vendim e elaboroi me anë të sllajdeve dhe kino-projektorëve, kurse në fund kërkon që të aprovohet ky propozim-vendim.

Ramiz Ramadani- zgjidhja urbanistike të cilën e ka propozuar DUMM, është një propozim i cili është bërë në pajtim të plotë me pronarët e parcelave në këtë lokacion, mendoj se është një zgjidhje specifike e cila i eliminon pengesat për realizmin e planit ekzistues dhe ne

konsiderojmë se kjo është një zgjidhje e pranueshme dhe ne do ta mbështesim në të gjitha fazat.

Florinë Zymberi- këtë propozim-vendim ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar në Komitetin për Urbanizëm dhe jemi dakorduar që kjo t' i rekomandohet Komitetit për Financa për aprovim. Kjo çështje duhet të zgjidhet, sepse jemi para aktit të kryer dhe nuk ka mundësi të tjera të zgjidhjes urbanistike dhe është bazuar edhe në planet rregulluese e të cilat janë në hartim e sipër. Në bazë të analizave që i kemi bërë ne si komitet kemi menduar që ta inkorporojmë në Planin rregullues “Qarku” ne jemi të vetëdijshëm se kjo i kushton buxhetit të Komunës, por duhet ta aprovojmë, sepse i ndihmojmë zgjidhjes urbanistike në këtë pjesë për një standard sa më të mirë të qytetarëve të kësaj pjese.

Izmi zeka- kush për aprovim të pikës 5 të rendit të punës ?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës : Propozim vendimi për miratimin e Zgjidhjes urbanistike për një pjesë të PDU: Zona Perëndimore “Qarku”, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit

Me këto pika dhe debate pjesa e parë seancës së II (dytë) i përfundoi punimet në ora 12.45 min

Procesmbajtësi

Sali Hasani

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA